26 June, 2011



në Podujevë vetëm ide

# ...reth ...zimit të hemodializës

...s së qendrës së dializës në ...h është edhe anëtar i ...në Kuvendin e Kosovës, ai ...ërë asgjë në këtë drejtim. ...tit si në atë lokal (Podujevë) ...ror ka bërë që këtë projekt



...ti çdoherë nga 30 pacientë me ...eshkave, të cilët kanë nevojë ...min e dializës

Insistimi i Thaçit se ai është i gatshëm që nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Podujevë do t'i dërgonte për trajnim një grup të punëtorëve shëndetësorë, në mënyrë që të jenë të gatshëm t'i trajtojnë pacientët, nuk i kishte bindur zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë për të lëshuar pe.

"Me hapjen e kësaj qendre, ne do t'i arrinim dy efekte: ua shkurtonim udhëtimin e stërzgjatur pacientëve të cilët duhet t'i marrim në shtëpi nëpër fshatra të thella të Llapit, t'i dërgojmë në QKUK, dhe pastaj t'i kthejmë prapë nëpër shtëpitë e tyre. Dhe e dyta nga ana ekonomike na dilte shumë me leverdi pasi sipas llogarive tona për çdo të sëmurë në ...

IADK-ja dhe EURED-i ndihmojnë fermerët e rajonit të Mitrovicës

# Inspektohen financimet nga BE-ja në agrikulturë

**Përfaqësuesi i BE-së, Brayan McCarty, ka inkurajuar fermerët e rajonit të Mitrovicës për punën që po bëjnë dhe ka thënë se njerëzit janë lodhur nga prodhimet industriale**

KOHA Ditore

*MUSA MUSTAFA*

MITROVICË, 25 QERSHOR - Zyrtarë të BE-së, të komunave të rajonit të Mitrovicës, si dhe ata të IADK-së, kanë inspektuar të shtunën financimet e tyre të përbashkëta në agrikulturë në rajonin e Mitrovicës. Vlera totale e këtyre financimeve arrin në gjysmë milioni euro.

Zyrtarë të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian ECLO kanë theksuar se këto investime janë më të qëlluarat. Brayan McCarty në fshatin Çabër të Komunës së Zubin-Potokut ka inspektuar serrën prej 5000 metrash katrorë, që është ndërtuar në bazë të standardeve evropiane.



Pronari i serrës, Ahmet Uka, është shprehur shumë i kënaqur me donatorët dhe ka bërë të ditur se pret që sivjet të prodhojë 15-20 tonë domate.

Ndërkaq Zenel Bunjaku, drejtor i IADK-së, ka thënë se shpagimi i donatorëve bëhet vetëm me punën e mirë që janë duke bërë fermerët. Në fshatin Vaganicë financuesit kanë parë nga afër punën që është bërë në ngritjen e një pemishteje me mollë në një sipërfaqe prej 1 hektar. Pronari Sylejman Shala ka bërë të ditur se ka mbjellë 2200 fidanë të mollës dhe ka investuar më se 12 mijë euro.

Zyrtarë të IADK-së kanë theksuar se një projekt që do të realizohet muajt në vazhdim është edhe ai i një ferme moderne me lopë qumështore në Vushtrri, si dhe një mini- fabrikë për përpunimin e frutave në Skënderaj.

Përfaqësuesi i BE-së, McCarty ka lavdëruar nismat si këto duke thënë se njerëzit janë lodhur nga prodhimet industriale. Kurse Rizah Haziri, zv.kryetar i Komunës së Mitrovicës, ka potencuar se mbështetja kësisoj për këtë komunë ka ndikuar edhe në zvogëlimin e shifrave të të papunëve.

"Ne si komunë do të mbështesim dhe do të ndihmojmë fermerët tanë në ngritjen sa më shumë të kapaciteteve prodhuese. Andaj apeloj tek banorët e kësaj treve që sa më shumë të konsumojnë prodhime vendore, pasi që këto prodhime janë edhe ma të shëndetshme", është shprehur Haziri.

Drejtoria e Shëndetësisë në Lipjan ua tërheq vërejtjen farmacistëve

# Barnatoret kërcënohen me gjoba për mosrespektim të kujdestarisë

**Sipas urdhëresës së autoriteteve lokale të Lipjanit, të gjitha barnatoret që veprojnë në këtë qendër obligohen t'i përmbahen orarit të rregullt të punës dhe atij të kujdestarisë, në të kundërtën gjobiten sipas ligjit. Farmacistët kërkojnë siguri nga ana tjetër**

KOHA Ditore

*ARIAN DURIQI*

LIPJAN, 25 QERSHOR – Drejtoria e Shëndetësisë në Lipjan ka kërkuar nga të gjithë farmacistët lipjanas që të jenë të kujdesshëm sa i përket respektimit të orarit të ...

hen edhe 11 të tjera, por që janë private. Veç kësaj, barnatore të hapura ka edhe në fshatrat Gadime, Janjevë e Magurë. Në Lipjan, ndërkaq, është organizuar kujdestaria për barnatoret deri në ora 2 pas mesnate për ...

zhvilluar me vetë farmacistët. Ndërsa, pas inspektimeve që kemi bërë nëpër këto barnatore nuk kemi gjetur se ato mbajnë barna me afat të skaduar", ka thënë Mziu. Për më tepër, nga ana tjetër, vetë farmacistët shprehen ...